

V E N D I M
Nr.485, datë 21.10.1999

PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË FONDEVE TË DHËNA NGA QEVERTIA E JAPONISË, SI MBËSHTETJE BUXHETORE, PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS SË KRIJUAR PËR SHKAK TË KRIZËS NË KOSOVË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës , të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.299, datë 24.6.1999, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e shpërndarjes të fondeve të grantit japonez, për mbështetje buxhetore si vijon:

- 200 milionë jen për Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, me destinacion mbështetjen e KESH-it, për importin e matësve elektrikë në bokse kolektive e individuale;

- 200 milionë jen për Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit me destinacion mbështetjen e Albpetrolit, për importin e naftës;

- 200 milionë jen për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit me destinacion mbështetjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave, për nevojat e saj për automatizimin e sistemit hekurudhor;

- 200 milionë jen për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, për mbështetjen e industrisë agroushqimore me linja teknologjike.

2. Ministrinë e sipërpërmendura, të marrin masat që në bashkëpunimin me konsulentin e huaj, në kuadrin e këtij projekti, si dhe kompanitë tregtare përfituese të këtyre fondeve, të përgatitin dokumentacionin e nevojshëm për prokurimin e mallrave që do të importohen në kuadrin e këtij granti.

Vlera e mallrave, pajisjeve dhe linjave teknologjike, që do të financohen nga granti, do të shlyhen si fonde kundërparti nga përfituesit përfundimtarë, me vlerën ekuivalente në lekë të çmimit të blerjes FOB, brenda datës 16 qershor 2002. Llogaritja në lekë do të bëhet sipas kursit të këmbimit të dërguar FMNsë, për muajin qershor 1999.

Për këtë qëllim, ministrinë përkatëse të marrin të gjitha masat për analizën e mundësive të kthimit të fondeve kundërparti, brenda afatit të sipërpërmendur, mundësinë e përballimit të detyrimeve tatimore dhe doganore për importet që do të realizojnë, si dhe për lidhjen e marrëveshjeve përkatëse me përfituesit përfundimtarë. Këto marrëveshje do të miratohen përfundimisht nga Ministria e Financave.

4. Ngarkohet Ministria e Financave për ndjekjen dhe monitorimin e të gjitha procedurave dhe transaksioneve, që lidhen me zbatimin e këtij granti.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtre.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko